




GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF
KOSOVO



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
Date: 09.01.2015
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A 10/2015
Dt: 12.01.2015

Q A R K O R E

PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË KPPK DHE LIGJIT PËR PROKURORIN
E SHTETIT, SA I PËRKET KOMPETENCËS TERRITORIALE NGA ANA E
PROKURORIVE DHE GJYKATAVE

Përkundër faktit se ligjet që kanë qenë të lidhura me mbikëqyrjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, kanë ndryshuar, me ligjin nr.04/L-273, i cili ka hyrë në fuqi 23.04.2014, prokurorët dhe gjyqtarët, akoma po i procedojnë çështjet penale në bazë të nenit 13. të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nr.03/L -053.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve, që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, të Republikës së Kosovës nr.04/L-273. i miratuar më 23.04.2014, përkatësisht neni 7.B.pika 1.1. është shfuqizuar neni 13 i Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë nr.03/L -053, me të cilën dispozitë ishte devijuar nga standardi; “sipas vendit të kryerjes së veprës penale”. Në rrethana të tanishme (nga prilli i vitit 2014) kompetenca territoriale për prokurori dhe gjykata, përcaktohet sipas kriterëve standarde “vendit ku dyshohet se është kryer vepra penale”.

Procedimi i çështjeve penale nga ana e prokurorëve dhe gjyqtarëve jashtë kompetencave territoriale të prokurorive-gjykatave ku ata e ushtrojnë veprimtarinë si prokurorë dhe gjyqtarë, janë arbitrare. Me ligjet relevante (Ligji mbi Prokurorin e Shtetit dhe KPPK) janë përcaktuar qartë kompetencat lëndore dhe territoriale dhe asnjë


prokuror dhe gjyqtar, nuk mund të ushtrojë mandatin e tij, jashtë kompetencave territoriale (nëse eventualisht nuk ka delegim kompetence).

Pas marrjes së kësaj qarkoreje, keni për obligim që çështjet që i keni në procedim, ndërsa nuk bien në kompetencën territoriale të prokurorisë-gjykatës suaj, t'ia procedoni prokurorisë-gjykatës kompetente.

Ju falënderoj për bashkëpunim dhe mirëkuptim.

Me respekt,

Prof.dr. Fejzullah Hasani


F. Hasani

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës